


# RELACION TEKNIK

## **“RIKONSTRUKSION I RRUGES SOTIR PEÇI”**

**TIRANE**



## I. Studim I gjendjes se strukturave ekzistuese dhe propozimi per permiresimin e tyre

Rruga "Sotir Peçi" shtrihet në pjesën veri-lindore të qytetit të Tiranës, kufizohet në veri me "Rrugën e Durrësit" dhe në pjesën perëndimore me rrugën "Skënderbej". Gjatësia e rrugës është rreth 150 m dhe shtrihet në një zonë me ndërtime të reja dhe të vjetra. Vlerësohet mjaft urgjente ndërhyrja në këtë bllok pasi ai është në një gjendje shumë të degraduar .

Ka një mundësi të rrugëve të asfaltuara, gjë që e bën mjaft të papranueshme nivelin e ndotjes së ajrit. Mundësia e një rrjeti rrugor , e ka bërë mjaft kaotike lëvizjen. Po të hedhesh një sy, rruga nuk e njeh fare termin „vend parkimi për automjetet“. Në këtë rrugë vërehet një mundësi totale për të takuar prezencën e koshave të mbeturinave . Që në një vështrim të shpejtë këtu vërehet qartë që kjo rrugë ka nevojë për një ndërhyrje emergjente sidomos në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza , ku pusetat janë si jashtë funksionit aq edhe pa kapak në të shumtën e rasteve . Nuk është e vështirë të gjykojë pas një shiu jo të rrembyeshëm që rrjeti i kanalizimeve të ujërave të shiut thuhet se ka pushuar së ekzistuari. Gjëlberimi është spontan në formën e shkurreve të uletë dhe tek tuku ndonjë pemë. Ky gjëlberim, në këto kushte, është shumë i paparshtatshëm pasi është mbartës i insekteve dhe kafsheve që rrezikojnë hapjen e epidemive të ndryshme. Ndrëçimi i brendshëm mungon.

Nga të gjithë vëzhgimi në terren na rezultoi që :

### **Infrastruktura rrugore**

Rruga ka një gjatësi rreth 150 m, ka një gjerësi që varion nga 3.5 deri në 4.5 m. Rruga në 100 metrat e para është e shtruar me asfalt, pjesa tjetër është pa shtresa asfaltike. Ka mundësi totale të trotuarëve.

### **Kanalizimet e ujërave të zeza**

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza ekziston në fillim të rrugës por mungon në pjesën tjetër të saj.

### **Kanalizimet e ujërave të bardha**

Mungon rrjeti i K.U.B.

### **Rrjeti ujësjellës**

Ka rrjet ujësjellës.

### **Rrjeti ndrëçimit rrugor**

Mungon rrjeti i ndrëçimit rrugor në këto rrugë.

## Gjelbërimi

Ka mungesë të gjelbërimit dhe pemëve në rrugë.

### Foto te gjendjes ekzistuese



Foto 1.



Foto 2.





Foto 3.



Foto 4.





Foto 5.



Foto 6.



Foto 7.



Foto 8.



## I. Hartimi i programit te aktiviteteve

Per realizimin sa me efikas te projektit kemi per qellim mbushjen e ketyre detyrave:

- Organizimin e burimeve njerezore dhe teknike te nevojshme per realizimin e ketij projekti.
- Organizimi dhe sigurimi i kontakteve me autoritetet kontraktore dhe ato lokale per nje bashkepunim te kenaqshem per realizimin e ketij projekti.
- Ogranizimi i grupit te punes dhe pergatitjet e stafit pjesemarres ne projekt.
- Sigurimi i standarteve dhe normativave te vendosura nga Termat e Referencave.
- Nenshkrimi i kontratave te domosdoshme dhe zgjedhja e specialisteve te fushave te ndryshme te inxhinierise, per hartimin e studimeve kerkimore duke permbushur kerkesat e projektit.

## II. Stafi i angazhuar per projektin

- Ing. Arben DERIVSHAJ (Inxh.rruge ,vepra arti)
- Ing. Ervin PAÇI (Inxh.rruge ,vepra arti)
- Ing. Skender ALLKJA (Inxh.gjeolog)
- Ing. Alfred LAKO (Inxh.mjedisi)
- Ing. Alket KUMARAKU (Inxh.hidroteknik)
- Ark. Daniel GJONI (Arkitekt)
- Ark. Ermonel MONKA (Arkitekt)
- Ing. Vilson GOSHI (Preventivues)
- Ing. Hysen Gjala (Inxh. elektrik.)
- Etj

---

# A . Pershkrimi i pergjithshem i menyres se punes

## I.Studimi paraprak

Do te studiohen disa alternativa me nderhyrje dhe me pas do te vendoset per alternativen me te mire  
Çdo studim do te kryhet ne baze te nje metodologjie me te cilen do te biem dakort me investitorin.  
Punimet qe do te kryhen brenda ketij studimi do te prekin te gjitha aspektet e pergjithshme urbanistike,funksionale dhe ekonomike te blloqeve te banimit.  
Ne kete faze fillestare te projektit do te rishikojme metodologjine e propozuar dhe do shqyrtojme me autoritetin kontraktues Bashkia Tirane per adoptimin sa me te mire te projektit ne perputhje me kerkesat e ketij autoriteti

## II.Studimi perfundimtar

Ne kete studim perfundimtar do te kryhet studimi i detajuar i çdo alternative te zgjedhur nga studimi paraprak urban , duke bere sistemimin e nevojshme te domosdoshem ne perputhje me nevojat aktuale dhe ato te parashikuara te popullates banuese ne kete zone ne lidhje me te dhenat statistikore mbi zhvillimin.

## III.Projekt zbatimi

Ne kete faze te projekt zbatimit do te realizohen me pergjegjesine me te madhe sistemimi I shesheve te ndertimit sipas kriterëve urbane,realizimi pike per pike I te gjithë elementeve arkitekturore sipas alternatives se miratuar.

Ne kete faze te project zbatimit do te kryhen llogaritjet e nevojshme, vizatimet, menyra e ndertimit dhe preventimi i detajuar ne libreza masash i cdo elementi inxhinierik.(rruget sekondare dhe kryesore te blloqeve,veprat hidroteknike ,elektrike etj)

Nje pershkrim te shkruar te detyrave qe do te zgjidhen sipas cdo grupi veprash , do te jepet me poshte.



Pas marrjes ne dorezim te sheshit te ndertimit behet organizimi I kantjerit.


Do te pajisen me makinerite e nevojshme per cdo proces pune. Merren masa per bllokimin dhe sinjalistiken e duhur per te treguar qe ne kete zone po kryhen punime.

Do te realizohet proceset e punimeve sipas grafikut te punimeve dhe afatit kohor te percaktuar ne te.


Do te kete nje bashkunim ndermejt firmes zbatuse dhe firmes projektuse per cdo problem qe mund te haset ne kantjer. Ky rikonstrukcion konsiston ne heqjen e paketes se shtresave ekzistuese. Do te realizohet rrjeti i ri elektrik dhe sistemi ujembledhes per zonen. Para realizimit te paketes se re te shtresave do te ngjeshet toka e germuar dhe me pas do te vendosen dy bazat granulare te percaktuara si ne projekt. Behet vendosja e bordurave dhe e shtresave asfaltike si dhe gjelberimi I zones sipas projektit.

Paketa e shtresave rrugore do te jete:


- Asfaltobeton 3cm
- Binder 5cm
- Baze granulare 1 (15 cm)
- Baze granulare 2 (25cm)




**PROFILI TERTHOR (PRERJA 2-2)**  
Shkalla 1:50



**PROFILI TERTHOR (PRERJA 3-3)**  
Shkalla 1:50



**PROFILI TERTHOR (PRERJA 4-4)**  
Shkalla 1:50



---

## B . Hartimi I pergjithshem I projekt-idese

### I. Standartet e projektimit

Duke iu referuar Termave te References projekti I rehabilitimit te rruges do te kryhet ne perputhje me standartin shqiptar te projektimit .Gjithashtu edhe per projektimin e veprave te artit do te ndiqen rigorozisht standartet shqiptare te projektimit.

Ne kemi propozuar nje variante vlere te cilit ka kaluar vleren e propozuar ne detyren e projektimit. Ky variant ka ne perberjen e tij te gjithe elementet qe rruga te kete standartet e projektimit.

Mund te propozojme dhe nje variant te dyte vlere e te cilit te jate sa fondi limit por ne kete do te perfshihen vetem zevendesimi I shtresave asfaltike.

Te gjitha zgjidhjet do te krahasohen me standartet europiane dhe amerikane.

Parametrat e kesaj kategorie do te jene si me poshte :

- Gjeresia e gjurmes se kalimit 3.25-4.5 m

### II. Punimet topografike

Punimet topografike jane nje pjese e rendesishme qe paraprin realizimin e projekti ne te gjitha etapat e tij. Ky studim krijon nje baze te sakte dhe te sigurte topografike ku materializohet me te dhena hartografike teresia e ambientit natyror ne duart e projektuesve te vepres.

Keto pika do ti sherbejne ndertuesit per piketimet perfundimtare te akseve te rrugeve ne terren.

Gjithashtu te fiksohen ne terren pikat fikse te fillimit, te mbarimit te rrugeve si dhe pika te tjera te rendesishme qe do te gjykohe e domosdoshme.

### III. Punimet e rrugeve

Ne menyre te domosdoshme duhet te riformulohet sistemi rrugor i brendshem, duke specifikuar keshtu dhe menyren e qarkullimit si per automjetet dhe per kembesoret. Kjo gje rregullon shume levizjen dhe e ben rrugen jo kaotike. Si rezultat i shtimit te numerit te makinave dhe ristrukturimit te rruges natyrisht qe duhet shprehur sakte dhe menyra e qarkullimit te ketyre. Ne projekt kjo gje duhet



shprehur shume qarte duke bere nje sistem shume te paster vijezimesh rrugore dhe sinjalistike vertikale.

Nje vemendje shume e vecante i duhet kushtuar edhe parkimeve. Mbi bazen e variantit perfundimtar te miratuar te projekt idese eshte menduar qe te behet nje bilancim ndermjet rrugeve dhe parkimeve.

#### IV. Projektimi parametrik i rrjetit rrugor

Nepermjet projektimit parametrik eshte e mundur te percaktohen te gjithë parametrat specifik te akseve te rrugeve te cilat jene pjese e projektit per rehabilitim ,ketu perfshihen gjeresite e karrexhatave te cilat do te behen ne baze te studimeve te miratuara , dhe ne perputhje me Termat e References ,bankinave,seksionet tip qe do te perdoren ne segmente te ndryshme te rrugeve.

#### V. Llogaritja e veprave hidraulike

Llogaritja e veprave si puseta ,tubacionet e kanalizimeve dhe shtrirja e rrjetit te kanalizimeve do te realizohet nga UKT sha.

#### VI. Kontrolli i normativave

Keto raporte konsistojne ne kontrollin si nga ana planimetrike ashtu dhe altimetrike, te te gjithë parametrave te elementeve projektuese duke verifikuar saktesine e tyre me normativat e vendosura. rrugore me specifikimet perkatese.

#### VII. Punimet e prishjeve

Punimet e prishjeve si dhe prishje te bordurave te betonit, pllakave ekzistuese te trotuereve qe do te rikonstuktohen dhe ne perfundim te kesaj faze transportimi i te gjithë ketyre mbeturinave do te realizohen ne kohen e duhur sipas projektit te zbatimit ,ne perputhje te plote me rregullat teknike si dhe pa prishur ritmin e jeteses se popullates se zones ne bllok.

## VIII. Krijimi i ambjenteve rekreative

Nje element shume kryesor i ketij kualifikimi eshte krijimi i ambjenteve rekreative. Keto mund te jene per te gjitha moshat, duke krijuar siperfaqe te gjelberuara. Te gjitha keto sherbime jane gjithashtu te lidhura dhe me kerkesat per banore qe kerkojne Termat e References

## IX. Kerkesat per leje apo licensa

Ky raport do te perfshije te gjitha lejet apo kerkesat, ne si konsulece duhet ti paraqesim, qe klienti duhet te siguroje gjate gjithe fazeve te projektimit dhe ndertimit te rruges.

## X. Raporti mbi konsultimin me publikun

Ne kete raport do te perfshihen te gjitha propozimet e konsultimit me publikun me te gjithe aktoret e interesuar apo te gjitha entet shtetore si Bordi i Kullimit, KESH, Ndermarrjet Ujeselles Kanalizimet, Telekom.

## XI. Punimet e dheut

Punimet e dheut si: punimet e germimit te shtresave ekzistuese dhe te germimeve te reja do te realizohen ne menyren me efikase te mundeshme duke respektuar kronologjine e punimeve te projektit .

## XII. Projektimi sipas alternativave dhe llogaritja e kosos se ndertimit (preventivit) sipas varianteve

Ky projektim sipas varianteve do te nise:

- Pasi te jete kryer rikonjucioni ne vend nga te gjitha grupet e projektimit, ballafaqimi me Termat e References dhe pas hartimit te grafikut te punimeve.
- Pasi te jene siguruar te gjitha materialet e mbledhura ekzistuese te domosdoshme
- Dhe ne varesi te kryerjes se punimeve topografike, dhe hidrologjike.

Variantet dhe nenvariantet gjate hartimit te projekt – idese do te konsistoje ne:

- Sistemimin e rruges sipas Termave te References dhe te standarteve europiane .

- Projektimin e rrugëve të blloqëve (brenda tyre dhe ato jashtë tyre që janë pjesë e projektit) të dhënë nga Termat e Referencave


Gjithashtu do të paraqesim të gjitha matjet inxhinierike që lidhen me largimin e ujërave sipërfaqësore në rrugë.

### XIII. Dokumentacioni i projekt – zbatimit

Si konsulencë, në bazë të analizave tekniko – ekonomike dhe studimeve të kryera në projekt – ide, do të paraqesim dokumentacionin si më poshtë

Dokumentacioni që do të përfshihet në projekt – zbatim do të jetë:

- Planimetritë e rrugës dhe nyjeve lidhëse
- Prerjet terthore tip, shtresat rrugore, detaje
- Harta e rievimit topografik
- Harta hidrologjike ku do të tregohen rrjedhjet ujore
- Planimetri të infrastrukturës nëntokësore dhe asaj mbitokësore me ndryshimet e propozuara



Pergatiti: Ing. Ervin PACI